



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-112/02-137827/21, datë:22.Dhjetor 2021

Në bazë të nenit 12.paragrafi 1 dhe 2 pika d), nenit 53.të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazetazyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 3, nenit 6 paragrafi 3 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë dt.21.12.2020, dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431 datë: 30.Shtator 2020, Kuvendi i Komunës në mbledhje e mbajtur me datë: 22. Dhjetor 2021, në propozim të përfaqësuesve të subjekteve politike dhe komuniteteve joshumicë në Komunën e Pejës, merr këtë:

V E N D I M

Nr.03/2021

MBI THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1.Miratohet Vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete si komitet i përhershëm në përbërje prej 9 (nëntë) anëtarëve, si vijon:

- 1.1.Xhenete Syka Kelmendi, anëtare e kuvendit nga subjekti politik - LDK, anëtare,
- 1.2.Hidajete Krasniqi, anëtare e kuvendit nga subjekti politik - AAK, anëtare,
- 1.3.Bujar Agusholli, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik - LVV, anëtarë,
- 1.4.Mirzet Dzegović, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik - BIP, anëtarë,
- 1.5.Avdullah Dzešević, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik - IBJ, anëtarë,
- 1.6.Mirsad Berisha, përfaqësues i komunitetit- egjiptian, anëtarë,
- 1.7.Sofije Toska, - / - - romë, anëtare,
- 1.8.Fatlinda Radi, - egjiptian, anëtarë, dhe
- 1.9.Miloš Dimitrijević, përfaqësues i komunitetit - serb, anëtarë.

2.Kompetencat – të drejtat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete janë përcaktuar me nenin 53 paragrafin 2. të LVL –së dhe nenin 43 të Statutit të Komunës së Pejës.

3.Anëtarët e Komitetit për Komunitete të zgjedhur me pikën 1 të këtij vendimi , zgjedhen për një mandatë të njëjt sikurse anëtarët e kuvendit.

4.Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhet nga radhet e anëtarëve të komitetit për komunitete me shumicë votashtë anëtarëve të komitetit.

5.Kompensimi i anëtarëve të komiteteve është i përcaktuar me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komuna: “Pjesëmarrja në çdo seancë të punës së komiteteve kompenzohet si shtesë në lartësi prej 50 € (Euro).

6.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari I Komunës dhe Drejtorja për Buxhet e Financa e KK. Pejë.

7.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

1x1.MAPL-së.s.

1x1.Kryetarit të Komunë

1x1.Anëtarëvetë KK-te.

1x1.DBF-ca

1x1.Arkivë.



KRYESUESI KUVENDIT ,

Rexhep Kurtbogaj